



Pranuar / Dërguar Punë/Prodato Received/Delivered	14.07.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHK	4132/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova -- Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.481/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.481/2022 të datës 25.05.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

në çështjen juridike "Vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër Anr.481/2022 e datës 25.05.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Formulari i ri-vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 28.04.2022 i Drejtorit i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit.

A r s y e t i m

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 më datë 01.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës kundër Formularit për Vlerësimin e Punës për vitin 2021 të datës 31.01.2022 me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 08.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa kjo e fundit me datë 18.03.2022 përmes Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Ankuesja përmes ankesës së datës 25.05.2022 ka kërkuar rishqyrtimin e ankesës së datës 01.03.2022 pasi që edhe pas rivlerësimit të rezolutave të punës sipas Vendimit të Këshillit A.nr.188/2022 të datës 13.04.2022, sërish është e pa kënaqur me rivlerësimin e rezultateve në punë 2021 me pretendimet ankimore se nuk janë respektuar rregullat dhe procedurat ligjore.

Kryetari i Këshillit me datë 08.07.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër VK.nr.65/2022 me qëllim të shtyrjes së afatit për vendosje edhe për dhjetë (10) ditë pune sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit të datës 07.07.2022 për shkak të nevojës të shqyrtimeve shtesë për shkak të specifikave të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 01.03.2022 me Nr.Prot:1072/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 28.02.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Shkresën e datës 08.03.2022 e dërguar nga ankuesja nëpërmjet e-maili e protokolluar me numër:1228/2022 me korrespondencën e bashkangjitur katër (4) faqesh; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 27.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 31.01.2022; Formulari për caktimin e objektivave për vitin 2021 i datës 08.01.2021; Raportin përshkrues për vitin për periudhën janar-dhjetor 2021; E-mailin e datës 27.01.2022 dërguar nga ankuesja për ministren e MASHT; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 e datës 31.12.2020; Planin vjetor të inspektoratit të arsimit për vitin 2021 i datës 29.12.2020; Planin vjetor të inspektoratit të arsimit për vitin 2021 i datës 08.01.2022; E-mailin e datës 24.11.2021 dërguar nga ankuesja për ministren e MASHT; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.03.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 18.03.2022 me numër prot:1439/2022 me përmbajtje prej 1/28 faqesh; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Inspektore e arsimit në departamentin e Inspektionit; Akt emërimit e ankueses të datës 02.04.2012; E-mailin e datës 25.11.2021 dërguar nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë për ankuesen; E-mailin e datës 17.01.2022 dërguar nga ankuesja për Shkresën e datës 18.03.2022 me numër prot:1441/2022 me provat e bashkangjitura shtesë; Ankesën e ankueses të datës 25.05.2022; Shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit të datës 28.04.2022 me numër reference:10/N.prot:349 me shkresat përcjellëse të lëndës; Formularin për ri-vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021; E-mailin e datës 25.11.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e *pa bazuar*, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 02.04.2012 mbanë pozitën "Inspektore e Arsimit" në Departamentit të Inspektionit të Arsimit në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa në bazë të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 me datë 31.01.2022 nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është vlerësuar me notë të përgjithshme tre (3)

kundër të cilit vlerësim e njëjta kishte parashtruar ankesë më datë 01.03.2022, ndërsa Këshilli përmes vendimit me numër A.nr.188/2022 të datës 13.04.2022 e kishte kthyer lëndën e ankueses në ri-shqyrtim dhe rivendosje për shkak të metave procedurale dhe metodologjisë apo formulës së përdorur për kalkulimin e notës së përgjithshme, dhe mbi këtë bazë Kolegji nuk ishte lëshuar në shqyrtim meritore të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, nëse vlerësimi ishte real për ankuesen.

Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit me numër Anr.188/2021 përmes shkresës së datës 28.04.2022 me referencë 10.Nr.prot:349 ka njoftuar se i ka evituar të metat të cilat i ka përmbajtur formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021 i datës 31.01.2022 duke e bashkangjitur formularin ri të vlerësimit si dhe duke dhënë sqarime shtesë lidhur me vlerësimin e ankueses për vitin 2021 me pretendimet se ankuesja nuk i ka përmbushur obligimet lidhur me raportimin për punën e bërë brenda afateve ligjore, nuk ka treguar rezultate që e njëjta të vlerësohet përtej pritjeve, ndërsa ankuesja përmes ankesës të datës 25.05.2022 kërkon që të ri shqyrtohet vlerësimi i rezultateve të punës respektivisht ankesa e datës 01.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 43 paragrafi 1 dhe 13 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku për caktohet se: *"Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 13. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton metodologjinë dhe procedurën e hollësishme të vlerësimit të rezultateve në punë"* ndërlidhur me nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku shprehimisht përcaktohet se: *"Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: Nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë", dhe po ashtu nenin 11 paragrafi 2 nën paragrafi i së njëjtës rregullore përcakton se: "Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: "mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës"* dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se me këtë vlerësim të ankueses udhëheqësi i drejtpërdrejtë i saj realisht ka konstatuar edhe pretendimet e ankueses, ngase e njëjta në kuptim të përmbledhur sipas vlerësimit të Kolegjit ka pretenduar se i ka realizuar të gjitha objektivat e parapara të punës për vitin kalendarik të vitit 2021 ngase vlerësimi me notë të përgjithshme 3-"mirë" edhe sipas dispozitave të rregullores në fjalë e ka këtë kuptim të pasqyruar si më lartë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankuesja me rastin e kërkesës për ri-shqyrtim të rastit të saj nuk ka ofruar asnjë provë apo dëshmi relevante përveç deklarimeve të saja në ankesën e datës 25.05.2022 e cila do të ishte bindëse se e njëjta jo vetëm që i ka realizuar të gjitha objektivat e punës por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit, sikurse Kolegji ka pasur parasysh edhe dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me avancimin në karrierë të nëpunësve civil siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 dhe 2 në paragrafi 2.3 të Rregullores

Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil: "1.Për të aplikuar për ngritjen në detyrë, personi duhet të plotësojë së bashku, kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2. Kushtet për ngritjen në detyrë janë: 3.2 nëpunësi të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet individuale në punë, gjatë dy (2) viteve të fundit para konkurrimit për ngritje në detyrë", andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se ankesa e ankueses është e pabazuar dhe si e tillë është refuzuar ngase sikurse është pasqyruar edhe më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, vlerësimi me notë të përgjithshme "3-mirë", është vlerësim i cili përcakton qartë se ankuesja i ka realizuar të gjitha objektivat e parashikuara të punës dhe po ashtu i njëjti vlerësim i shërben në kuptim pozitiv për ngritje në karrierë apo avancim në detyrë, i cili njëherit parashihet si njëri ndër parakushtet kryesore.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.481/2022**

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit/MASHT;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.